



853
08.03.2017

436
20.03.2017

UNIVERSITETI I SHKODRES “Luigj Gurakuqi”

Rektori

Nr. 702 prot

Shkodër, më 08.03.2017

AKT- MARRËVESHJE

E lidhur sot me datë _____ 2017, midis Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” përfaqësuar nga rektori prof.dr.Adem Bekteshi dhe Spitalit Rajonal Shkodër, përfaqësuar nga Drejtori Z./Znj. _____.

Baza ligjore

Ligjet nr. 80, datë 22. 07. 2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimit shkencor në institucionit e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”

Kodi Civil ligji nr.7850, dt.29.07.1994 me ndryshimet përkatëse, pjesa V-te, ”Kontratat” titulli I-re (kreu I re deri tek kreu III-të), titulli II-te(kreu VII-të), nenet 850 e vijim.

Qëllimet e bashkëpunimit: Institucionet nënshkruese të kësaj marrëveshje konfirmojnë nevojnë e përpjekjeve në drejtim të konsolidimit të vlerave kulturore, shkencore dhe akademike në vend, e cila ndikon pozitivisht në drejtim të forcimit të klimës së shtetit të së drejtës dhe impenjohen:

- Të punojnë së bashku në fryshtëzime, reciprocitetit, transparencës, lehtësimit të pjesëmarrjes dhe zhvillimin e kapaciteteve të nevojshme në drejtimin e studimeve shkencore;
- Të promovojnë iniciativat shkencore dhe të shkëmbimit kulturor me qëllim rritjen e kapaciteteve njerëzore në drejtimin e studimeve shkencore;
- Të nxisin promovimin e standardeve më të larta në cilësinë e kërkimit si edhe të integritetit etik në punën kërkimore.

Neni 1

Objekti i marrëveshjes

Bashkëpunimi ndërmjet dy institucioneve do të përfshijë dy drejtime.

A) Bashkëpunimi i përgjithshëm institucional nëpërmjet:

- Përcaktimit të fushave kërkimore me qëllim integrimin midis strukturave për aktivitetin didaktiko-teoriko-praktik, të zhvilluar në mbështetje të kurseve universitare dhe pasuniversitare;

- Shkëmbimit të kapaciteteve të burimeve njerëzore të institucioneve në aktivitete didaktike, projekte të kërkimit shkencor me interes të përbashkët si: konferanca, seminare, bashkëbisedime me studentë të tjerë;
- Mbështetjes së kërkimit shkencor të orientuar drejt praktikës duke u mbështetur nga metodologji të bazuara në vëzhgime të thelluara dhe të situatave komplekse, raste studimore, anketime ose racionalizëm të përvojës së akumuluar menaxheriale dhe konsultative të institucioneve;
- Organizimit të përbashkët të kurseve specifike, trajnimeve, leksioneve të hapura apo seminareve në lidhje me tematika që kanë interes studimor ose praktik.
- Shkëmbimit të materialeve dhe rezultateve të punës studimore dhe shkencore që realizohet në të dy institucionet;
- Krijimit të lehtësive për kryerjen e praktikave mësimore të studentëve të "Universitetit të Shkodrës" pranë institucionit përkatës dhe institucioneve në varësi;

B) Bashkëpunimi në fushën e studimeve do të konkretizohet nëpërmjet:

- Mbështetjes dhe bashkëpunimit reciprok në organizimin e projektit kërkimor shkencor të Universitetit të Shkodrës si dhe në organizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë në fusha të ndryshme.
- Gatishmërisë së Bashkisë Shkodër për të mirëpritur studentët e regjistruar në programet studimore për të konsultuar materialet e ndryshme të institucionit dhe institacioneve në varësi, me qëllim kërkimin shkencor dhe praktikën profesionale sipas rregullave të këtij të fundit.
- Mbështetjes dhe bashkë-udhëheqjes të studentëve gjatë realizimit të projektit shkencor dhe praktikës profesionale.
- Mundësimin nga ana e Bashkisë për realizimin e praktikave mësimore për programet e studimit të studentëve të Universitetit të Shkodrës Luigj Gurakuqi

Neni 2

Të gjitha aktivitetet e përmendura në nenin 1 do të bazohen mbi reciprocitet.

Neni 3

Palët para çdo fillim viti akademik do bien dakort mbi format dhe fushat konkrete të bashkëpunimit. Angazhimet e përbashkëta mund të ndryshohen dhe të amendësohen nga një marrëveshje e shkruar dhe e firmour nga të dyja palët.

Neni 4

Aktivitetet e përbashkëta do të rishikohen çdo vit.

Neni 5

Afati i kësaj akt-marrëveshje është 3 vjeçare duke filluar nga data e nënshkrimit.

Neni 6
Akt-marrëveshja hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit të saj nga palët.

Neni 7
Palët kanë të drejtë të propozojë aneksime dhe ndryshime të dokumentit në formë të shkruar dhe ndryshimet do fillojnë pas përshtatjes së tyre nga palët.

Neni 8
Palët kanë të drejtë të ndërpresë akt-marrëveshjen duke paraqitur një lajmërim me shkrim të paktën 1 një muaj para afatit.

Neni 9
Aktivitetet që nuk janë përfshirë në këtë akt-marrëveshje do akordohen nga palët, të cilat do vazhdojnë të kenë kontakte, vullnetin e mirë, fleksibilitetin dhe cilësinë e adaptueshme për realizimin e kësaj akt-marrëveshjeje.

Neni 10
Kjo akt-marrëveshje u hartua në 4 katër kopje e do të quhet e vlefshme duke filluar nga data e nënshkrimit të saj nga palët.

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

REKTORI

Prof.dr. Adem BEKTESHU



Spitali Rajonal Shkodër

DREJTORI

Z./ Zm. [Signature]

